



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/171

Datë: 19.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/171

Datë: 19.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 25 të Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për kryesues dhe anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës, këta kandidatë:
  - 1.1. Ahmet Krasniqi, Kryesues;
  - 1.2. Halit Shabani, anëtar;
  - 1.3. Ramë Manaj, anëtar dhe
  - 1.4. Arbnor Kastrati, anëtar.
2. Obligohet Sekretari i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me biografitë e të propozuarve t'ia procedojë për shqyrtim dhe emërim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


Nr. 03/171

Datë: 19.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) euro për organizimin e ndeshjes së parë ndërkombëtare miqësore ndërmjet përfaqësueses së Republikës së Kosovës dhe Haitit, të lejuar nga FIFA.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në Kodin e Programit 801 në kategorinë ekonomike të subvencioneve.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/171

Datë: 19.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6.3 dhe 14.3 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, si dhe me propozimin e Ministrit të Infrastrukturës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Z. Kreshnik Gashi, emërohet Zëvendësdirjtor i Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.
2. Posti i Zëvendësdirjtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës është post me orar të plotë.
3. Zëvendësdirjtorin e Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës emërohet për një mandat pesë vjeçar dhe mund të rimërohet nga Qeveria edhe për mandate të tjera pasuese me kohëzgjatje të njëjtë.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zëvendësdirjtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe delegimin e funksioneve të përcaktohen në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, e cila nxirret në pajtim me Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.
5. Procedura e shkarkimit dhe procedurat tjera vlejné në mënyrë analoge siç është përcaktuar për dirjtorin e përgjithshëm.
6. Obligohet Ministria e Administratës Publike të përcaktoj pagën e Zëvendësdirjtorit, sipas pikës 1. të këtij vendimi në përputhje me nenin 20.2 të Ligjit për Aviacionin Civil.

7. Obligohet Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/171

Datë: 19.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Themelohet Këshilli Organizativ për Manifestimin gjithë-popullor për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e cila do të organizohet nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi më 5, 6 dhe 7 mars, në këtë përbërje:
  - 1.1. Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kryesues;
  - 1.2. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, anëtar;
  - 1.3. Përfaqësues, Komuna e Skenderajt, anëtar;
  - 1.4. Përfaqësues, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, anëtar;
  - 1.5. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Jashtme, anëtar;
  - 1.6. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar.
2. Ftohen që ta dërgojnë nga një përfaqësues në këshill:
  - 2.1. Zyra e Presidentes, anëtar;
  - 2.2. Kuvendi, anëtar;
  - 2.3. Komuna e Prishtinës, anëtar;
  - 2.4. Organizatat e dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar;
  - 2.5. Asociacioni i Komunave të Kosovës, anëtar; dhe
  - 2.6. Përfaqësues të OJQ-ve.
3. Për punën e Këshillit Organizativ ndahen mjete financiare në vlerë prej 40,000.00 (dyzetë mijë) euro të cilat do të shfrytëzohen sipas nevojës për manifestim.

4. Mjetet financiare nga pika 3. e këtij vendimi ndahen nga Rezervat e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në kodin nr. 10700 në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Zyrën e Kryeministrit.
5. Obligohet Ministria e Financave, Zyra e Kryeministrit dhe Këshilli për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë